



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT
DREJTORIA PLANIFIKIMEVE DHE MENAXHIMIT

Nr. _____ prot.
2019

Tiranë, më ____ . ____ .

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: “Akademia Shendetit Publik” shpk me Nipt: **L32402038K**, me Adresë:
Rruga Tre Vellezerit Kondi, Nr. 6/1, Tirane, me Administrator Znj. Aferdita Bala.

- 1.Procedura e prokurimit: “**Kerkese për Propozim**”
- 2.Numri i References se Proçedures: REF-24831-05-30-2019
- 3.Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Sherbim dezinfektimi të bimësisë dekorative**
4. Fondi Limit: **6 510 000** (gjashtë milion e pesëqind e dhjetë mijë) **lekë pa tvsh.**
5. Burimi i të ardhurave: **Bashkia Tiranë.**
6. Kohëzgjatja e kontratës : 6 muaj nga data e lidhjes se kontrates
7. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët
8. Data e zhvillimit të procedures: **24.06.2019 ora 10:00**

Njoftojme se ka qenë pjesëmarrës në procedurë operatorët ekonomik si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Akademia Shendetit Publik” shpk me Nipt: **L32402038K** me ofertë ekonomike:

6 460 000 (gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) **lekë pa tvsh.**

7 752 000 (shtatë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë) **lekë me tvsh.**

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi **“Akademia Shendetit Publik” shpk** nga ku rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- I plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike

2. Operatori ekonomik “Fatos Lashi” PF me Nipt: K91315005H me ofertë ekonomike:

6 280 800 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind) **lekë pa tvsh.**

7 536 960 (shtatë milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) **lekë me tvsh.**

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi **“Fatos Lashi” PF** nga ku rezulton se:

Operatori Ekonomik **“Fatos Lashi”**, person fizik nuk plotëson pikën 2. nënpikën (i) të DST-ve pasi në rastin e kamionçinës së llojit Nissan me targë AA375JO, përkatësisht dokumenteve të kontrollit teknik dhe siguracionit të automjetit, këtyre dokumentave i ka kaluar afati.

Gjithashtu automjeti i llojit kamionçinë i tipit Nissan Navara me targë AA803DO, përkatësisht dokumntacionit të paraqitur për kontrollin teknik të mjetit dhe siguracionin e mjetit i ka kaluar afati. Kjo përbën shkak për skualifikimin e OE **“Fatos Lashi”** person fizik.

OE **“Fatos Lashi”** person fizik nuk plotëson pikën 2, nënpika (b) të DST-ve pasi AK ka kërkuar të paktën 3 atomizatorë shpine me motorr për granula, ndërkohë që nga ana OE është paraqitur dokumentacioni për vetëm 2 atomizatorë, ku përkatësisht Nr. I Matrikulave është 160174 dhe 160176. Gjithashtu OE **“Fatos Lashi”** person fizik ka paraqitur vetëm një faturë blerjeje për atomizatorin dhe jo të paktë 3 ashtu siç edhe është kërkuar nga AK. Kjo përbën shkak për skualifikimin e OE **“Fatos Lashi”** person fizik.

OE **“Fatos Lashi”** person fizik nuk plotëson pikën 2, nënpika c të DST-ve pasi nuk ka paraqitur dokumenta të cilat vërtetojnë blerjen apo pronësinë e të paktën 3 Dozatorëve MMF. Kjo përbën shkak skualifikimi për OE OE **“Fatos Lashi”** person fizik.

OE **“Fatos Lashi”** person fizik nuk plotëson pikën 3 të DST-ve pasi nuk ka

paraqitur dokumentacionin e plotë me të dhënat e sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet e përcaktuara.

OE “Fatos Lashi” person fizik nuk plotëson pikën 6 (nënpika e DST-ve) pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk vërtetohet që trajnimi i punonjësve dhe rrjedhimisht çertifikatat e paraqitura janë të njohura nga Institucionet e Shtetit Shqipëtar.

OE “Fatos Lashi” person fizik nuk plotëson pikën 7 të DST-ve pasi nuk ka paraqitur kontratë bashkpunimi për trajnim punonjësish me Autoritetet Shqiptare siç edhe kërkohet nga ana e AK.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe dokumentave të tenderit të miratuar, u konstatua se oferta e shoqërisë “Akademia Shendetit Publik” **shpk** është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **si ofertë të vlefshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë sigurimin e kontratës, dhe nënshkrimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi u bë me datë **16.07.2019** në sistemin elektronik të APP-së

Ankesa: Nuk ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arlinda Binjaku